VENDIM
Nr. 48, datë 23.3.2022

MBI SHTYRJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s PËR KËRKESËN E SHOQËRISË "HERA" SHPK, PËR TRANSFERIMIN E PLOTË TË LICENCËS NR. 49, SERIA NPM07P, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT NR. 61, DATË 2.11.2007, "PËR NDËRTIM, INSTALIM, SHFRYTËZIMIN DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALE ME ERË (PROJEKTI KAPPET)", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2017; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.3.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 382/2-1 prot., datë 18.3.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizime dhe Mbikëqyrjes, "Mbi kërkesën e shoqërisë "HERA" sh.p.k., për transferimin e plotë të licencës nr. 49, seria NPM07P, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar, "Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)", të ndryshuar,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 240, datë 2.12.2021, vendosi:

1. Të fillojë procedurën për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë "HERA" sh.p.k., me nr. 49, seria NPM07P, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar, "Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)", me kapacitet të instaluar 150 mw, për një afat 30-vjeçar.

2. Vendimi përfundimtar për transferimin e licencës së shoqërisë "HERA" sh.p.k. do të merret pasi Bordi i ERE-s të jetë shprehur në lidhje me shtyrjen ose jo të afateve të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar.

- Me *email*-in e datës 17.3.2022, në ERE kanë mbërritur: shkresa e protokolluar me tonën me nr. 65/5 prot., datë 18.3.2022, shkresa nr. 65/6 prot., datë 18.3.2022 dhe shkresa nr. 65/7 prot., datë 18.3.2022, të shoqërive "HERA" sh.p.k. dhe "SOT AL" sh.p.k. të cilat kanë vijuar me depozitimin e dokumentacionit shtesë që i është kërkuar nga ERE, në lidhje me këtë praktikë.

- Me qëllim shqyrtimin e këtij dokumentacioni për të dalë më pas me propozimin përfundimtar, në lidhje me kërkesën për transferimin e licencës së shoqërisë "HERA" sh.p.k. te shoqëria "SOT AL" sh.p.k. vlerësojmë shtyrjen me 30 ditë pune të afatit të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s, në mbështetje të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", në lidhje me këtë kërkesë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen e Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë "HERA" sh.p.k., për transferimin e licencës nr. 49, seria NPM07P, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar, "Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)".

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti